

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vendimi në Hagë, Ali Ahmeti: E padrejtë, beteja vazhdon në apel - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/vendimi-ne-hage-ali-ahmeti-me-besim-ne-drejttesi-beteja-vazhdon-ne-apel/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 11:51:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 11:47:26 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	cd4f803e4a6d605c12eac957e894e19ff9fd559983297d44d30bb112db0bc438
TEKSTI	1111af349c71e60b94eb7d35244a55ea230465a80779d43f2157c9211a53875f
PAMJA	cc3cad2e62e21981baae09891b3ef0399b7c91418f4ca41d3580260d5133bc7c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	241d8b9d815e21f603a833e5821e05c205c97c76808cec0458a1de92b44e8f29
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/241d8b9d815e21f603a833e5821e05c205c97c76808cec0458a1de92b44e8f29>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Gjyqi i UÇK Ali Ahmeti BE fatmir Limaj Ursula von der Leyen

KOSOVË | RAJONI

Vendimi në Hagë, Ali Ahmeti: E padrejtë, beteja vazhdon në apel

16 Shtator 2026 | 13:47

Kreu i BDI-së, Ali Ahmeti ka reaguar pas vendimit të marrë këtë të mërkurë në Hagë e cila dënoi me 81 vite burg në total 4 ish-krerët e UÇK-së. Ahmeti u shpreh se vendimi është i padrejtë dhe zhgënjyës.

Ai shtoi se procesi nuk përfundon këtu teksa shtoi se drejtësia do të kërkohet në Gjykatën e Apelit. Sipas tij, historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet dhe sakrificat e një populli të tërë nuk mund të vihet në bankën e të akuzuarve.

“Vendimi i sotëm ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit është një vendim që e konsideroj të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyës.

Në këto momente të rënda, bëj thirrje për maturi dhe unitet. Nuk duhet të biem në asnjë grackë që synon të krijojë tensione, përçarje apo të njollojë luftën çlirimtare të popullit në Kosovë.

UÇK-ja lindi si përgjigje ndaj shtypjes dhe luftoi për lirinë e Kosovës. Pretendimet e dikurshme për trafikim organesh, që rënduan për vite mbi UÇK-në dhe drejtuesit e saj, nuk u shndërruan në akuza në këtë proces. Po ashtu, sot Gjykata i shpalli të pafajshëm të akuzuarit për krime kundër njerëzimit; dhe potencoi se UÇK kishte pasur objektiv pavarësine e Kosovës, objektiv ky që edhe u arrit. Këto janë fakte që duhet të kujtohen sa herë që dikush përpiqet ta paraqesë UÇK-në si ndërmarrje kriminale.

Aktakuza i ngarkonte Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin me përgjegjësi për një sërë krimesh të pretenduara gjatë viteve 1998-1999. Besojmë se edhe këto akuza do të rrëzohen në procesin e mëtejshëm gjyqësor, ashtu siç nuk u materializuan pretendimet e dikurshme për trafikim organesh.

Procesi nuk përfundon këtu. Besojmë se mbrojtja do ta vazhdojë betejën juridike në Gjykatën e Apelit, duke kundërshtuar gjetjet e shkallës së parë dhe duke kërkuar drejtësi deri në fund.

Lufta e UÇK-së ishte luftë për liri. Historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet dhe sakrificat e një populli të tërë nuk mund të vihet në bankën e të akuzuarve. Me besim në drejtësi, beteja vazhdon në apel”, shkruan ai.

LAJMI I FUNDIT

13:40 BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje

13:40 Limaj pas vendimit në Hagë: Aktgjykim i padrejtë, jo në emër të popullit të Kosovës

13:38 Avokati i Thaçit: I rashës kokës me grushte kur gjyqtari tha në emër të popullit të Kosovës

13:28 Gjendja e Unionit, pesë përfundimet kryesore nga SHPËRNDARJA e Gjykatës së Apelit: Gjyrimi i Ursula von der Leyen

13:26 Pagat e magjistratëve, Prokuroria e Përgjithshme: Diferenca të pajustificuara dhe jo harmonike

13:11 Osmani: UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë, dje, sot e përjetësisht

TESTIM

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me 25 vite burgim. Rexhep Selimi është dënuar me 13 vjet burgim. Kadri Veseli u dënua me 18 vjet burgim.

Limaj pas vendimit në Hagë: Aktgjykim i padrejtë, jo në emër të popullit të Kosovës

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

KOSOVË | RAJONI

BE për dënimet e ish-krerëve të UÇK-së, thirrje për përmbajtje: Gjykata të lejohet të veprojë pa ndërhyrje

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje të gjitha palëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbajtje pas aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit,...

13:40 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

Limaj pas vendimit në Hagë: Aktgjykim i padrejtë, jo në emër të popullit të Kosovës

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj ka reaguar lidhur me dënimin e ish-krerëve të UÇK-së. Ai u shpreh se vendimi i sotëm ishte një nga...

13:40 | 16/09/2026

KOSOVË | RAJONI

Avokati i Thaçit: I rashës kokës me grushte kur gjyqtari tha në emër të popullit të Kosovës

Avokati i Hashim Thaçit, Pierre-Richard Prosper, e ka cilësuar vendimin ndaj ish-presidentit të Kosovës si një "tallje me drejtësinë", ndërsa ka bërë të ditur se...

13:38 | 16/09/2026

TEMA	SHËRBIME	KOMPANIA
Vendi	Live	Rreth Euronews
Rajoni	Lajmi fundit	Kushtet e përdorimit
Bota	Na ndiqni	Politika e cookie
Video	Euronews Radio	Kontaktoni
	Për persona me aftësi të kufizuara	Punësimi

Follow Euronews on all platforms: